

20211071665

**LIGJ I HUAMARRJES I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT NGA BANKA
NDËRKOMBËTARE E RINDËRTIMIT DHE E ZHVILLIMIT - BANKA BOTËRORE
SIPAS MARRËVESHJES SË HUAZIMIT PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË
MODERNIZIMIT TË BUJQËSISË**

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut merr hua nga Banka Ndërkombëtare e Rindërtimit dhe e Zhvillimit - Banka Botërore, në shumë prej 46.000.000 euro, të dedikuar për realizimin e Projektit të modernizimit të bujqësisë.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas, sipas nenit 1 të këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshjen e huas për financimin e Projektit të modernizimit të bujqësisë, që do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bankës Ndërkombëtare të Rindërtimit dhe të Zhvillimit -Bankës Botërore.

Në emër të Republikës së Maqedonisë së Veriut, marrëveshjen e huas, sipas paragrafit 1 të këtij neni, do ta nënshkruajë ministri i Financave.

Neni 3

Afati i shlyerjes së huas, sipas nenit 1 të këtij ligji, është 12 vjet, me përfshirjen e periudhës grejs prej katër vjetësh.

Shkalla e kamatës është EURIBOR gjashtëmuor, i rritur për shtrirje fikse.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes së huas, sipas nenit 2 paragrafi 1 të këtij ligji, Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare të Rindërtimit dhe të Zhvillimit – Bankës Botërore provizion të njëhershëm në shumë prej 0,25% të shumës së huas.

Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare të Rindërtimit dhe të Zhvillimit – Bankës Botërore provizion në lartësi prej 0,25% të pjesës së patërhequr të huas në nivel vjetor.

Huaja do të paguhet në 16 këste gjysmëvjetore, secila në shumë prej 6,25% të shumës së huas. Huaja do të paguhet çdo vit, më 15 mars dhe 15 shtator.

Neni 4

Shfrytëzues i mjeteve të huas, sipa nenit 1 të këtij ligji, është Ministria e Bujqësisë, e Pylltarisë dhe e Ekonomisë së Ujërave.

Neni 5

Republika e Maqedonisë së Veriut huan, sipas nenit 1 të këtij ligji, do ta paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.